

## **Fjala përshëndetëse e Ambasadores Gjermane në Tiranë**

**Znj. Susanne Schütz**

**me rastin e Ditës së Bashkimit të Gjermanisë**

**4 tetor 2016**

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

ju përshëndes përzemërsisht me rastin e festës së Ditës së Bashkimit të Gjermanisë.

Jam veçanërisht e lumtur të mirëpres sot Kryetarin e Kuvendit zotin Meta.

Gjithashtu u uroj përzemërsisht mirseardhjen ministrave, deputetëve, përfaqësuesve të gjyqësorit, kryetarët dhe përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe të trupit diplomatik.

Ky është përvjetori i 26-të i Ditës së Bashkimit të Gjermanisë. Ne të gjithë e mbajmë mend rënien e Murit të Berlinit më 9 nëntor 1989, që çoi në rivendosjen e Bashkimit të Gjermanisë dhe kapërcimin e ndarjes së Evropës. Me mbarimin e Luftës së Ftohtë edhe Shqipëria mundi të clirohej prej dekadash të tëra diktature dhe izolimi dhe të rikthehej në gjirin e familjes së shteteve evropiane.

Sot, 26 vjet pas ribashkimit, Gjermania vazhdon t'i qëndrojë idesë evropiane si projekti më i madh i paqes pas Luftës së Dytë Botërore. Ndaj ajo mbështet përpjekjet e Shqipërisë për tu anëtarësuar në komunitetin e solidaritetit dhe te vlerave të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst edhe procesi i Berlinit iniciuar prej Qeverisë Gjermane, do të ndihmojë Shqipërinë dhe mbarë rajonin të afrohet më pranë Bashkimit Evropian. Kështu ne shpresojmë që krahas projekteve të mëtejshme në krijimin e rrjeteve të ndyshme në rajon, ai i ngritjes së Zyrës rajonale të bashkëpunimit rinor RYCO të mund të nisë sa më shpejt punën në Tiranë, ashtu sikurse është planifikuar.

Muajt e fundit Shqipëria ka hedhur hapa vendimtarë në kuadër të reformës në drejtësi. Ky është një kusht thelbësor që Komisioni Evropian të japë rekomandimin e tij për celjen sa më të shpejtë të mundshme të Bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë. Por hapa të tjerë përpara priten. Ndaj i bëj thirrje ndjenjës së përgjegjësisë së të gjitha forcave politike, të mos i lënë pas dore tani hapat e mëtejshëm të reformës dhe para së gjithash zbatimin e saj. Këtu është fjala në mënyrë të vecantë për forcimin e besimit të popullsisë shqiptare në politikë dhe drejtësi si dhe për tu dhënë njerëzve një perspektivë më të mirë në vendin e tyre. Por përtej kësaj bëhet fjalë edhe që investitorët e huaj të gjenë këtu kushtet e duhura, sigurinë ligjore dhe kredibilitet institucional, që më pas të kenë mundësi të shfrytzojnë potencialin ekonomik që ofron Shqipëria.

Gjermania është angazhuar prej mëse një qerq shekulli me projekte të shumta në Shqipëri, ndër të tjera në sektorin e arsimit profesional, zhvillimit rural dhe menaxhimit të ujrave dhe energjise, duke mbështetur kështu vendin tuaj me një vlerë të përgjithshme prej pothuaj një miliardë euro sigurisht edhe me asistencën e GIZ, KfW dhe organizatave të shumta joqeveritare e partnerëve shumëpalësh. Shpresoj që përpara mbylljes së vitit të mund të lidhim marrëveshje edhe për projekte të tjera të bashkëpunimit ekonomik.

Një rëndësi e vecantë i kushtohet edhe bashkëpunimit kulturor mes Gjermanisë dhe Shqipërisë. Këto ditë jemi duke ofruar për të dhjetën herë Tetorin Gjerman, pra javët gjermane në Shqipëri. Së bashku me partnerë të shumtë dhe falë mbështetjes së sponsorizuesve tanë besnikë në gjashtë javët në vijim do të shfaqim një program të ngjeshur dhe të larmishëm në Tiranë, por edhe jashtë saj, në Shkodër, Korçë dhe Elbasan. Katalogu i aktiviteteve të Tetorit Gjerman është printuar dhe ekspozuar, që të mund ta merrni me vete. Do të gëzohesha nëse shumë prej jush do t'i rishihja në këto aktivitete.

Edhe interesi për gjuhën gjermane është në rritje të vazhdueshme. Vetëm para pak ditësh inauguroam një ndërtesë të re dhe mjaft të denjë të Qendrës Goethe në Tiranë. Falë bashkëpunimit të ngushtë në sektorin e arsimit rritje ka shënuar edhe numri i nxënësve dhe studentëve që mësojnë gjermanisht në shkolla dhe universitete.

Të nderuar zonja dhe zotërinj, ndodhem prej pak kohësh në vendin tuaj, por që tani kam vënë re një interes të fuqishëm për Gjermaninë si dhe për zemërsinë e madhe të shqiptarëve. Për mua është kënaqësi që së bashku me kolëgët e koleget në Ambasadën Gjermane të mbështesim rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian dhe të intensifikojmë më tej marrëdhëniet tona dypalëshe që edhe tani mund të thueht se janë mjaft të mira.

Përpara se ta mbyll dëshiroj të falënderoj për zemërsisht z. Gentian Rushi dhe kuartetin e tij.

Dhe tani uroj për të gjithë ju një mbrëmje të këndshme, biseda të mira dhe shpresoj shumë që tek ne do të ndiheni mirë.